



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK
BASHKIA TIRANË

V E N D I M

Nr. 7, datë 13.02.2021

**“PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE TË NËNPROGRAMIT TË GRANTIT TË
RIKONSTRUKSIONIT, BANESAT E TË CILËVE JANË KLASIFIKUAR NGA
AKTEKSPERTIZAT E THELLUARA NGA INSITUTI I NDËRTIMIT ME NIVEL DËMI
DS4”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, pikës 2, të vendimit nr. 160, datë 7.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rikonstruksionit/rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga aktekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh DS4 dhe DS5”, urdhrit nr. 11408/1, datë 25.03.2020, të kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programi i grantit të rindërtimit”, të ndryshuar, si dhe në vijim të Raportit e Komisionit të Posaçëm, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e raportit të komisionit të posaçëm për aplikimet e kryera për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit, për banesat e klasifikuara nga aktekspertizat e thelluara të Insitutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS4.
2. Miratimin e listës të subjekteve përfituese nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit, pjesë e programit të rindërtimit, sipas aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Subjektet përfituese të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, përfitojnë vlerën e rikonstruksionit sipas parashikimeve të vendimit nr. 160, datë 7.12.2020, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rikonstruksionit/rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga aktekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmsh DS4 dhe DS5”, të ndryshuar.
4. Vlera konkrete financiare e grantit të rikonstruksionit për secilin përfitues, të përcaktohet nga njësitë administrative/lagjet e Bashkisë Tiranë, në bazë të planimetrisë përkatëse të dorëzuar nga nga përfituesit, e cila hartohet nga projektues të licencuar dhe i bashkëlidhet kontratës përkatëse, ku identifikohet qartë struktura e banesës së dëmtuar, përkatësisht 1+1; 2+1 dhe 3+1 ose më shumë.
5. Bashkia Tiranë ngarkohet të korrigjojë gabimet në rast se evidentohen në listat e përfituesve të përcaktuar në këtë vendim, si dhe në aktet e tjera të këshillit bashkiak që kanë për objekt shpalljen e listave fituese nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit. Korrigjimet i paraqiten këshillit bashkiak për miratim.

7. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Tiranë.

8. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Njësitë Administrative dhe Lagjet e Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO